Nr. 938 Prot.

15.09.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
|SHKOLLA E MESME PROFESIONALE
HOTELERI - TURIZEM"

RREGULLORE
E
BORDIT DREJTUES
SHKOLLA E MESME PROFESIONALE "HOTELERI - TURIZËM"

Adresa: Rruga e Kavajes 50

e-mail :hoteleriturizem_tirane@yahoo.com

Neni 1
Baza ligjore

Rregullorja e Bordit Drejtues të shkollës së mesme profesionale "Hoteleri - Turizëm", këtu më poshtë Bordi mbështetet në Ligjin nr. 15/2017, datë 16.02.2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", i ndyshuar, Udhëzimin nr. 759, datë 30.09.2024 "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit", i ndryshuar, Udhëzimin nr. 28 datë 30.07.2018 "Mbi kriteret për pjesëmarrjen, organizimin dhe funksionimin e bordit drejtues të ofruesve publikë të arsimit e formimit profesional" si dhe Rregulloren e Brendshme të Institucionit.

Neni 2
Qëllimi

1. Kjo Rregullore zbatohet brenda institucionit dhe rregullon përbërjen, funksionimin, veprimtarinë e Bordit, dhe raportet e Bordit me të tretët.
2. Çdo aspekt tjetër i cili nuk është parashikuar në këtë rregullore, rregullohet sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 3
Struktura organizative e Bordit Drejtues

1. Bordi Drejtues i institucionit është një organ kolegjial, i cili merr vendime për drejtimin e përgjithshëm strategjik, planifikimin e përgjithshëm dhe përdorimin e burimeve njerëzore, financiare, materiale e fizike dhe mbështetjen e aktivitetit të administrimit të institucionit, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm.
2. Bordi kryesohet nga Kryetari i Bordit.
3. Veprimtaria e Bordit asistohet nga Sekretari i Bordit.
4. Bordi përbëhet nga 7 anëtarë, përfaqësues të sektorit publik, sektorit privat dhe të institucionit të cilin ai drejton.
5. Bordi përbëhet nga:
   a) Dy përfaqësues të sektorit privat që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në profilin/et që ofron institucioni;
   b) Një përfaqësues i njësisë arsimore vendore (drejtorisë rajonale/ zyrës arsimore) që mbulon institucionin ofrues;
   c) Një përfaqësues të këshillit të qarkut që mbulon institucionin ofrues;
   d) Një përfaqësues të zyrës rajonale/ vendore të punësimit që mbulon institucionin ofrues;
   e) Një përfaqësues të personelit mësimdhënës të institucionit ofrues;
   f) Një përfaqësues të nxënësve për shkollat ose një përfaqësues i punëmarrësve për qendrat publike të formimit.

Neni 4
Procedurat e ngritjes së Bordit

1. Procedura për ngritjen e bordit dhe zëvendësimin e anëtarëve, të cilëve i ka mbaruar mandati ose largohen nga detyra kryhen/bëhen me kërkesë/ftesë të Drejtorit të institucionit.

2. Për përzgjedhjen e përfaqësuesve të sektorit publik.
   a) Drejtori i institucionit kërkon zyrtarisht me shkresë drejtuesve të institucioneve publike përkatëse të caktojnë përfaqësuesin e tyre në Bord.
   b) Mandati i tyre është i pacaktuar në varësi të kohëzgjatjes apo ndryshimeve të mundshme në pozicionin e tyre të punës në administratën publike.

3. Për përzgjedhjen e përfaqësuesve të sektorit privat.
   Drejtori i institucionit i drejtohet me shkresë zyrtare shoqërive Tregetare, organizatave të biznesit apo operatorëve tregtar:
   a) me aktivitet ekonomik qe lidhet me drejtimin që ka numrin më të madh të nxënësve apo praktikantëve që ka institucioni/
   b) përfaqësues me reputacion ne fushën ku operojnë apo kanë mbështetur më shumë institucionin gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij;
   c) zhvilloj aktivitetin e tyre në rajonin ku ndodhet institucioni ofrues.

4. Mandati i përfaqësuesve të sektorit privat është 4-vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje vetëm 1 herë.
5. Kërkesë- përgjigja për pjesëmarrjen në Bord shoqërohet me një letër motivimi, për disa kandidatura. Në bazë të kërkesës dhe plotësimit të kritereve të mësipërme Drejtori i institucionit përzgjedh 2 anëtarët e Bordit që do të përfaqësojnë sektorin privat.
6. **Për përzgjedhjen e përfaqësuesve të institucionit.**
   a) Përfaqësuesi i personelit mësimdhënës zgjidhet me votim të fshehtë nga personeli mësimdhënës i institucionit, me shumicë të thjeshtë të votave;
   b) Përfaqësuesi i nxënësve zgjidhet nga Qeveria e Nxënësve me shumicë të thjeshtë votash (*vetëm në rastet kur institucioni është arsimor*).
7. Mandati i përfaqësuesit nga personeli mësimdhënës është 4 vjeçar, pa të drejtë rizgjedhje.
8. Mandati i përfaqësuesit të nxënësve zgjat për sa kohë anëtari gëzon këtë status në institucion.

Neni 5
Funksionet dhe detyrat e Bordit Drejtues

1. Bordi Drejtues, ushtron funksione dhe detyrat si më poshtë:
   a) Garanton qëndrueshmërinë financiare të institucionit dhe përmbushjen e misionit të tij;
   b) Me propozim të Stafit Drejtues të institucionit shqyrton dhe miraton planin vjetor dhe afatmesëm të institucionit;
   c) Me propozim të Stafit Drejtues të institucionit shqyrton dhe miraton buxhetin për vitin pasardhës;
   d) Me propozim të Stafit Drejtues të institucionit shqyrton dhe miraton drejtimin e përgjithshëm strategjik të institucionit;
   e) Me propozim të Stafit Drejtues të institucionit shqyrton dhe miraton planifikimin e përgjithshëm dhe përdorimin e burimeve njerëzore dhe plan buxhetin e institucionit;

f) Me propozim të Stafit Drejtues të institucionit shqyrton dhe miraton planin vjetor të promovimit të institucionit;
g) Mbështet aktivitetet shkollore, praktikat profesionale ne biznes dhe aktivitete jashtë kurrikulare të institucionit;
h) Shqyrton dhe jep pëlqimin e tij për projekt propozimet e Njësisë së Zhvillimit të Shkollës pas miratimit të tyre nga Drejtori i Institucionit;
i) Shqyrton dhe miraton projekt propozimet që vijnë nga Stafi Drejtues i shkollës në lidhje me zgjerimin/ ndryshimin/ shtimin e profile ekzistuese apo të reja që ofron Shkolla;
j) Përcakton rregullat për shpërndarjen e të ardhurave që siguron institucioni nga ushtrimi i veprimtarive të tij, si dhe mbikëqyr përdorimin e burimeve financiare;
k) Shqyrton dhe miraton në fillim të vitit shkollor planin vjetor të veprimtarisë së Bordit;
l) Kërkon largimin e Drejtorit të institucionit në rastin e masave disiplinore.

2. Bordi Drejtues ka të drejtë të informohet për të gjitha aspektet e veprimtarisë së institucionit dhe shqyrton mbi baza tre mujore realizimin e planit.

Neni 6
Kryetari i Bordit

1. Bordi zgjedh midis anëtarëve të sektorit privat kryetarin e Bordit. Kryetari drejton veprimtarinë e bordit dhe mbledhjet e tij. Në mungesë të tij këtë detyrë e kryen përfaqësuesi tjetër i sektorit privat, të cilit i delegohet detyra nga kryetari.
2. Kryetari i Bordit shkarkohet me votim të fshehtë të anëtarëve të Bordit, me shumicë të thjeshtë. Votimi për shkarkimin e kryetarit të Bordit zhvillohet nëse kërkohet nga të paktën 3 anëtarë në rast të:
   a) moskryerjes në mënyrë të duhur të detyrave;
   b) mos realizimit të objektivave dhe qëllimeve të Bordit për vitin shkollor;
   c) mungesave (të pajustifikuara) të vazhdueshme në mbledhje: dy mungesa radhazi, ose më shumë se 3 mungesa gjatë vitit mësimor.
3. Veprimtaria e bordit drejtohet nga kryetari pozicionin e të cilit e mban përfaqësuesi i sektorit privat.
4. Mandati i Kryetarit të Bordit është 4 vjeçar me të drejtë rizgjedhje.

Neni 7
Funksionet e Kryetarit të Bordit

Kryetari i Bordit ka këto funksione:
a) thërret mbledhjet e Bordit;
b) vendos rendin e ditës në mbledhjen e Bordit, pasi është konsultuar dhe me anëtarët e tjerë;
c) ndan detyrat mes anëtarëve të Bordit;
d) në varësi të natyrës së mbledhjes dhe çështjeve në diskutim fton në mbledhjet Bordit persona të interesuar (Stafin Drejtues, personel të interesuar/ përfaqësues të nxënësve e prindërve, ose të ftuar të tjerë sipas rastit);
e) ndjek realizimin dhe përmbushjen e vendimeve të marra në Bord;
f) kryen çdo detyrë tjetër të parashikuar në aktet nënligjore përkatëse dhe Rregulloren e brendshme të institucionit.

Neni 8
Sekretari i Bordit

1. Veprimtaria e Bordit asistohet nga Sekretari i Bordit.
2. Sekretari i bordit është sekretari i institucionit dhe në pamundësi, drejtori i institucionit cakton një përfaqësues të personelit mësimdhënës.
3. Sekretari i Bordit është i detyruar të asistojë të gjitha mbledhjet e zakonshme dhe të jashtëzakonshme të Bordit.
4. Në rast mungese ai mund të zëvendësohet me urdhër të Drejtorit të Institucionit.

Neni 9
Funksionet e Sekretarit të Bordit

Sekretari i Bordit ka këto detyra:
a) njofton anëtarët për datën, vendin dhe rendin e ditës së mbledhjes;
b) përgatit materialet didaktike për mbledhjen;
c) mban procesverbalin e mbledhjes;
d) reflekton/ zbardh vendimet e Bordit;
e) dorëzon në protokollin e institucionit procesverbalet e mbledhjeve e dokumentet e tjera, të cilat arkivohen më pas.

Neni 10
Mbledhjet e Bordit Drejtues

1. Mbledhjet e Bordit thirren nga kryetari, të paktën 4 anëtarë ose Drejtori i institucionit.
2. Mbledhjet e Bordit thirren nga kryetari i Bordit në raste të zakonshme të planifikuara paraprakisht sipas rendit të ditës.
3. Mbledhjet e Bordit thirren nga të paktën 4 anëtarë kur këto të fundit konsiderojnë me rëndësi një çështje apo propozim i cili nuk është planifikuar në mbledhjet e zakonshme të bordit dhe kur Kryetari i Bordit nuk e përfshin atë në rendin e ditës së mbledhjes pasardhëse.
4. Mbledhjet e Bordit thirren nga Drejtori i institucionit në raste të jashtëzakonshme, për nevoja të paparashikuara dhe të nevojshme të institucionit. Drejtori i institucionit në këtë rast është anëtar pa të drejtë vote në Bord.
5. Mbledhjet e Bordit quhen të vlefshme kur marrin pjesë të paktën 5 anëtarë, përndryshe shtyhen për një datë tjetër të afërt.

Neni 11
Pjesëmarrja e Drejtorit të institucionit në mbledhjet e Bordit

Drejtori i institucionit, mund të ftohet të marrë pjesë në mbledhjet e Bordit në rastet kur:
a) Miratohet drejtimi i përgjithshëm strategjik i institucionit;
b) Miratohet buxheti i institucionit për vitin pasardhës;
c) Miratohet plani vjetor dhe afatmesëm i institucionit;
d) Si dhe në të gjitha rastet kur mbledhjet e Bordit thirren nga drejtuesi i institucionit.

Neni 12
Frekuenca e mbledhjeve të Bordit

1. Si rregull, Bordi thirret në mbledhje një herë në tre muaj, me përjashtim të rasteve kur në mbledhjen e radhës vendoset ndryshe, ose kur kërkohet mbledhje jashtë radhë nga anëtarët e cituar në nenin 10 të kësaj Rregulloreje.
2. Bordi duhet të mblidhet domosdoshmërisht para fillimit dhe para përfundimit të vitit shkollor.

Neni 13
Vlefshmëria e Vendimeve të Bordit

1. Vendimet e Bordit merren me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve pjesëmarrës në mbledhje (50% +1).
2. Vendimet e Bordit marrin fuqi juridike dhe bëhen të zbatueshme vetëm kur nënshkruhen nga Kryetari dhe anëtarët pjesëmarrës në mbledhje.

Neni 14
Mbarimi i mandatit të anëtarit të Bordit

1. Mandati i anëtarëve të Bordit mbaron para kohe në rastet kur:
   a) Dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
   b) Jep dorëheqjen nga Bordi apo pozicioni i punës;
   c) Është në pamundësi për të kryer detyrën;
   d) Konstatohet konflikt interesi;
   e) Janë konstatuar shkelje të rënda të ligjit ose etikës.
2. Bordi merr vendim me shumicë të thjeshtë në rastet e mbarimit të mandatit të anëtarit të bordit, pas konstatimit të një nga rastet e lartpërmendur.
3. Në rast mbarimi të parakohshëm të mandatit të anëtarit, mandati i anëtarit të ri të zgjedhur është plotësues.

Neni 15
Hyrja në fuqi e rregullores

Rregullorja e Bordit Drejtues, hyn në fuqi me miratimin e saj nga Bordi Drejtues kur në mbledhje janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Bordit dhe është votuar unanimisht pro saj.

K/Bordit
Fatos CERENISHTI
Fatos Çerenishti

Informacion për Dokumentin	
	SHKOLLA E MESME PROFESIONALE "HOTELERI - TURIZËM"
Emërtimi i Dokumentit	Rregullore e Bordit Drejtues
Miratuar nga:	Bordi Drejtues
Data e miratimit	15/09/2025
Numri i vendimit	338
Numri i faqeve	7
Data e hyrjes në fuqi	15/09/2025
Shpërndarja	Për përdorim të brendshëm
Kodi i dokumentit	RBD-09SH2025